



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 06 Prot

Datë, 11.03.2020

VENDIM

Nr. 2, datë 11.03.2020

PËR

**NGRITJEN E KOMISIONEVE TË ZGJEDHJEVE NË FAKULTETE (KZF) NË
UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORË**

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të nenit 7, pika 1 të Vendimit të Senatit Akademik Nr. 59, datë 11.02.2020 "Për miratimin e Rregullores për organizmin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, Vendimit të Komisionit Institucional Zgjedhor Nr.1, datë 11. 03. 2020 "Për kryerjen e detyrave funksionale të Komisionit Institucional Zgjedhor përmes komunikimit telefonik dhe elektronik", Komisioni Institucional Zgjedhor,

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e procedurave për ngritjen e Komisioneve të Zgjedhjeve në Fakultete (KZF).
2. Të miratojë përbërjen e Komisioneve të Zgjedhjeve në Fakultete, prej 3 (tre) anëtarësh me të drejtë vote: 2 (dy) anëtarë personel akademik, 1 (një) anëtar përfaqësues i studentëve dhe sekretari i KZF-së.
3. Të miratojë hapjen e procedurave dhe njoftimin për vetëkandidim për anëtarë të Komisioneve të Zgjedhjeve në Fakultete dhe sekretar të KZF-së në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.
4. Të miratojë periudhën kohore të pranimit të vetëkandidimeve nga data 12. 03. 2020, deri në datë 13. 03. 2020, brenda orarit zyrtar, 8:00-16:00.
5. Vetëkandidimet kryhen në rrugë elektronike në adresën e Komisionit Institucional Zgjedhor kiz@univlor.edu.al.
6. Vendimi publikohet në faqen web www.univlor.edu.al.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar i Komisionit Institucional Zgjedhor
Oljana Hoxhaj**

Anëtarët

Shkelqim Sinanaj

Eljona Zanaj

Evis Allushi

Kristi Mucollari